

Community Building Mitrovica

Raporti i auditimit të pavarur

Pasqyrat Financiare për vitin 2016

Final

PËRMBAJTJA:

Opinioni.....	1,3
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas funksionit.....	4
Bilanci i gjendjes.....	5-6
Pasqyra e ndrrimit në ekuitet.....	7
Pasqyra e rrjedhës së parasë.....	8-9
Shënime shoqëruese të pasqyrave mbi burimet dhe përdorimin e fondeve.....	10-14
Shënime mbi Pasqyren e të Hyrave dhe Përdorimit të Fondeve.....	15-23
Shkurtesat.....	24

Raporti i Audituesit të pavarur mbi auditimin e pasqyrave financiare

Community Building Mitrovica

Asambles

Isa Boletini nr.11

Mitrovicë

Opinion

Kemi audituar pasqyrat financiare të OJQ **Community Building Mitrovica (CBM)**, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2016, pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të CBM me 31 dhjetor 2016, të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë dhe janë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Baza për opinionin

Auditimin e kemi kry në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin "*Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare*", të këtij raporti. Jemi të pavarur nga organizata sipas kriterëve nga Kodi Etikë për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë të arsyeshme për opinion.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

Vijimësia

Pasqyrat financiare, janë përgatit mbi bazën e vijimësisë, drejtimi nuk ka për synim likuidimin as ndërprerjen e veprimtarisë së vetë për 12 muajt e ardhshëm. Auditimi nuk ka identifikuar ekzistencën e ngjarjeve apo kushteve të cilat krijojnë dyshime mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi.

SHM

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare

Informacione tjera, financiare ose jo financiare që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra, të përfshira në raportin vjetor të organizatës dhe që kanë mospërputhje materiale me PF ose me njohjen e siguruar nga audituesi gjate auditimit, ku çdonjëra prej tyre mund të dëmtojë besueshmërinë e PF dhe të raportit të audituesit mbi këto pasqyra, nuk janë identifikuar.

Përgjegjësitë e drejtimi dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF-NVM dhe për kontrole për të cilat drejtimi mendon se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse drejtimi ka për qëllim të likujdojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë zgjidhje tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare, si tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garanci se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale në rast se ato ekzistojnë. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu jemi përgjegjës të:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontroleve.

- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë të rëndësishme për auditimin në mënyrë që të planifikojm procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të

STT

japim një opinion mbi efikasitetin e kontroleve të brendshme të organizatës.

-Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga drejtimi.

- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e hipotezës së vijimësisë e përdorur nga ana e drejtimit dhe bazuar nga evidenca e përfutur e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditimit, në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfutur deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.

-Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjen, nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Kemi komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësie domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Prishtinë 30.03.2017.

Audit Office Shpk
Ulpiana D1/7 H-8
Shaban Muharremi,
Auditor Ligjor
44 112-036.



Te hyrat dhe shpenzimet sipas funksionit

Për 01.01- 31.12.	Në €	Nota	Shpjegimi	2016	2015
Burimet					
Te hyrat e shtyra ne fillim				116,217	283,946
Kontributet		1	8-	488,991	254,028
Te hyrat tjera		2	8-	-	11,319
Te hyrat e shtyra ne fund				44,860	116,217
Total Sources				560,347	433,076
Përdorimi i burimeve					
Projektet e realizuara		3	9	521,104	414,212
Personeli, përfitimet (Pagat)		4	9	39,243	18,863
Zhvleresimi/Amortizimi		7	9	-	-
Burimet e shfytëzuara ne total				560,347	433,076
Teprica-Mungesa e fondeve				-	-
Shpenzimet tjera				-	-
Teprica/mungesa neto		10		-	-

Shiqo shpjegimet mbi pasqyren e të hyrave dhe përdorimin e fondeve

Aferdita Syla, Drejtore Ekzekutive



Besnik Uka, Përgjegjës Financiar

Bilanci i gjendjes

Saturday, December 31, 2016

	Në €		2016	2015
I Pasurit				
A. Qarkulluese				
Arka		4,7	68,022	146,933
Llogarit e arkëtueshme		5-	24,691	174
Huazimet		7	-	81
Totali i mjeteve qarkulluese			92,712	147,188
B. Fixe				
Pajisjet, Inventari		6	-	-
Totali i mjeteve fixe			-	-
Totali I Pasurive A+B			92,712	147,188
II Detyrimet				
A. Afat-shurtera				
Llogarit e pagueshme		5	16,817	1,457
Detyrimet rrjedhese		9	2,670	-
Te hyrat e shtyra			44,860	116,217
Totali i detyrimeve afat-shkurtera			64,347	117,674
B. Afat-gjata				
Huazimet, Provisionet, tjera			-	-
Totali i detyrimeve afat-gjata			-	-
Totali I detyrimeve A+B			64,347	117,674

III Kapitali		6
Bilanci fillestar	10	28,365
Teprica-Mungesa e burimeve	10	-
Korigjimi i hapjes fillestare		1,149
Totali i kapitalit		29,514
Kapitali & Detyrimet (II+III):		147,188

Shiqo shpjegimet mbi pasqyren e te hyrave dhe perdorimin e fondeve



[Handwritten Signature]

Afërdita Syla, Drejtor Ekzekutiv

Besnik Uka, Përgjegjes Financar

Pasqyra e ndrrimit në ekuitet

7

për vitin që përfundon më 31. Dhjetor

	Kap.themeltar	Të hyrat e shtyra	Rezervat tjera	Gjithësej
GJENDJA MË 1 JANAR 2015	29,514			29,514
Teprica/mungesa e fondeve				-
Diferencat nga përkthimet valutore				-
Dividendat				-
Deponimet e kapitalit shtesë				-
Ndarja e rezervave				-
GJENDJA MË 31 DHJETOR 2015	29,514	-	-	29,514
Rritja/zvoglimi i të hyrave të shtyra				-
Diferencat nga përkthimet valutore				-
Dividendat				-
Deponimet e kapitalit shtesë				-
Ndarja e rezervave			-177	-177
GJENDJA MË 31 DHJETOR 2016	29,514	-	-177	29,337

Shiqo shpjegimet mbi pasqyrën e të hyrave dhe përdorimin e fondeve

Afërdita Syla, Drejtor Ekzekutiv

Besnik Uka, Përgjegjes Financar

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

	2016	2015
I RRJEDHA E PARSE NGA AKTIVITETET OPERATIVE:		
Të hyrat e shtyra +/-	-71,357	-167,729
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme	-	-
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme	-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	-	-
Të ardhurat financiare MINUS	-	-
Shpenzimet financiare	-	-
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve +/-	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
	-	-
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
(Rritja)/zvogëlim në llog. e arkët.tregtare dhe të tjera	-24,517	5,669
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	-	-
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	-81	969
Rritja/(zvogëlimi) në llog.e pagueshme tregtare dhe të tjera	15,345	585
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	1,698	1,150
	-7,555	8,373
Tatimi në fitim i paguar	-	-
Interesi i paguar	-	-
I RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIV. OPERATIVE	-78,911	-159,356
II RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVI.INVESTUESE		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme	-	-
Interesi i arkëtuar	-	-
Dividendat e arkëtuara	-	-
II RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIV.INVESTIUERE	-	-
III RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET FINANCUERE:		

Deponimet e kapitalit shtesë	-	-
Dividendat e paguara	-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	-	-
Pagesat e lizingut financiar	-	-
III RRJEDHA NETO E PARASË NGA AKTIV.FINANCUESE	-	-
RRITJA/(ZVOGLIMI)NETO I PARASË DHE EKVIVALENTËVE TË PARASË	-78,911	-159,356
PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FILLIM TË VITIT	146,933	306,289
PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FUND TË VITIT	68,022	146,933

Shiqo shpjegimet mbi pasqyren e te hyrave dhe perdorimin e fondeve

Afërdita Syla, Drejtor Ekzekutiv



Besnik Uka, Përgjegjes Financar

Notat shpjeguese mbi burimet, përdorimin e fondeve, pasurisë dhe detyrimeve

	2016	2015
Totali i burimeve në €		
1. Kontributet:		
BFPE Beograd	13,216	5564
Komisioni Evropian	339,154	96,278
EULEX-i	45,352	32,881
Fondacioni MOTT	31,040	30,441
Ambasada e Holandës	-	479
Departamenti i shtetit Amerikan - Ambasada Amerikane	34,295	40,221
Komuna e Mitrovicës së Jugut	19,229	1,600
Platforma Civikos	900	773
SOROS-KFOS	-	3,720
CSSP Qendra Berlin	12,644	11,227
OJQ D&G Solutions	21,386	12,625
PAX for Peace	60,321	13,346
Ambasada e Norvegjese	18,162	-
Instituti GAP	1,000	-
Rock Shkolla e Mitrovicës	215	547
OFAJ	8,282	3,726
Kolegji Nderkombetare i Biznesit Mitrovice	-	600
OJQ CRYM	13	-
Totali i kontributeve:	605,208	254,028
2. Kontribute/Te ardhura te tjera		
Rimbursimet (shpenzimeve, TVSH)	-	11,319
Totali i te ardhurave te tjera	-	11,319

3. Shpenzimet Programore:

Activist Lab Mitrovica	3,504	-
Qeraja per aktivitetet programore	2,550	3,600
Peticioni Veopro	-	-
Access Program	13,300	47,658
Eulex kampanja mediatike 2012	35,254	28,057
Nderto Ura Jo Mure	-	2,768
Aktivitetet (projektet) te tjera	200	400
Konferenca, Seminare	-	6,869
Stafi i perfshire ne aktivitetet e projekteve	114,532	134,503
Totali i Shpenzimeve te Programit	169,340	223,855

4. Kostot dhe perfitimet e stafit (shpenzimet e pagave)**4/1 Personeli**

Shpenzimet e pagave	29,857	15,594
Pensionet e paguara nga punedhenesi	28,505	15,594
Shpenzimet e paparashikuara ne paga	1,352	-
Tarifa e konsultimit	-	-
Te tjera	-	-

4/2 Kostot rjedhese

Provizioni bankar	32,684	37,840
Mirembajtja	610	339
Te pakonsumeshmet (pa zhvlersim, Pajisje, Mobilje)	765	260
Qeraja	1,380	6,961
Materialet per zyre	14,131	15,231
Telekomunikimi, telefoni fiks.	6,265	5,232
Sherbimet komunale	1,263	282
Shpenzimet e automjeteve (sigurimi, regjistrimi, mirembajtja etj.)	6,844	8,203
	1,427	1,333

	12	
4/3 Shpenzimet e udhetimeve	15,789	19,868
Shpenzimet e udhetimeve nderkombetare	7,859	11,589
Shpenzimet e udhetimeve lokale	7,930	8,279
4/4 Shpenzime te tjera	303,292	132,649
Kostot e paplanifikuara	-	990
Perkthyesit, interpretuesit	7,351	9,118
Takime per rritjen e numrit te organizatave ne MMT	416	-
Keshilltarët e ekipit monitorues të CBM	-	5,000
Vizitë studimore në vendet e BE	1,903	6,327
Vizita kthjese në vendet e rajonit	12,500	-
Grat Mentore	55,459	-
Sub-granting	112,473	-
Provizioni për konsulencë për zhvillim	2,000	-
Auditimi	4,130	4,100
Trajnime te ndryshme	7,687	29,605
Planifikimi i nderimit te kapaciteteve institucionale	18,115	23,290
Shpenzimet e konferencave/seminareve	5,955	-
Panairret	13,100	-
Kostot e vlerismit	17,359	-
Studimet, hulumtimet	12,942	-
Promovimi dhe përfaqësimi	12,663	15,872
Transporti dhe akomodimi	2,328	1,150
Vizibiliteti	2,640	-
Monitorimi i institucioneve lokale	14,270	37,198
4/5 Shpenzimet indirekte	9,386	3,269
Totali i shpenzimeve direkte	9,386	3,269

5. Paraja dhe ekuivalentët e saj

	31-Dec-2016	31-Dec-2015
PCB 111	5,792.78	69,703.80
PCB 163	3,622.42	367.09
PCB 190	17.97	76,421.46
PCB 192	58,588.52	440.58
Total paraaja:	68,021.69	146,932.93

6. Llogaritë e arkëtueshme, parapagimet

Komuna e Mitrovices	24,691	174
D&G Solutions	19,229	-
Pax Mitrovica	5,403	-
Të ndryshme (Ngritja e punonjësve)	37	174
	22	

7. Huate tek partneret

CRYM Koalicioni	-	81
	-	81

8. Tatimin në burim

Tatimit ne burim i të ardhurave	1,698	-
Kontributi pensional per punetore	645	-
Detyrimet e tatimit ne qira	1,365	-
	-312	-

9. Llogaritë e pagueshme, akrualet

Iniciativa për perspektivën evropiane	16,817	1,457
Byroja e përkthimit Fida	1,250	-
Grante te papaguara	2,082	-
Ko-Plan Consulting	2,600	-
	8,784	-

Instituti për Ndikimin e Zhvillimit	599	14
Umbrella P.R. N.Sh.	1,298	-
Hib Petroll	133	117
Vala	-	64
VIPPRINT	-	600
NGO CWD	-	90
TUANA Perkhime	-	400
Uniteti SH.A.	-	15
Vivianti	-	144
Taxi ALBANI	-	27
Tjera	72	-
		147,189

10. Hapja fillestare në 01.01.

<u>10/1 Paraja:</u>	146,933
Banka	146,933
Arka	-

10/2 Pasurite dhe pajisjet

<u>10/3 Llogarite e arketueshme:</u>	174
--------------------------------------	------------

10/4 Llogarite e pagueshme:

	81
--	-----------

Informata të përgjithshme dhe struktura qeverisëse

Sipas marëveshjes së angazhimit të nënshkruar me CBM, kemi bërë auditimin e pasqyrave financiare për periudhën që përfundon më 31 dhjetor 2016.

CBM është e regjistruar si organizatë jo-qeveritare sipas Ligjit Nr. 04/L-57 "Liria e Asociimit në OJQ", me Nr. 5101872-9 nga 13.02.2003, dhe Numrin Fiskal 600239992

Emri i plotë është "Community Building Mitrovica", shkurtesa C.B.M.

Statuti i Organizatës përcakton dy organizma të qeverisjes:

1.Organi më i lartë i qeverisjes është **Asambleja**, e cila ushtron detyrat dhe përgjegjësitë në bazë të Statutit dhe akteve tjera të CBM, përbëhet nga anëtarët me integritet, reputacion dhe kompetencë si dhe nga qytetarët dhe aktivistat e interesuar nga shoqëria civile dhe është përgjegjëse për aprovimin dhe ndryshimin e Statutit, për politikën dhe punën dhe financat e organizatës e shqyrton dhe aprovon raportin vjetor e poashtu e përzgjedh dhe shkarkon antarët e Bordit Ekzekutiv.

Kuvendi i Anëtarëve është mbledhë dy herë në nëntor 2016. (artikulli 14 i Statutit).

2.Organizata ka **Bordin** i cili paraqet organin qeverisës dhe mbikqyrës përgjegjës për kontrollin dhe drejtimin e punës dhe pasurisë së organizatës.

Personi i autorizuar, nga Bordi Ekzekutiv, është Drejtori Ekzekutiv i cili e përfaqëson organizatën dhe pranon të gjitha njoftimet zyrtare në emër të saj si dhe njofton autoritetet për çdo ndryshim eventuale të formës organizative ose selisë së organizatës.

Aktivitetet specifike dhe fushat e ekzaminimit

Synimi kryesor i organizatës është iniciimi, ripërtirja dhe normalizimi i marrëdhënjëve me komunitetin në regjionin e Mitrovicës me qëllim të promovimit të bashkpunimit, bashkjetësës dhe vlerave demokratike si dhe ndihma shoqërisë civile përmes:

- Stimulimit dhe përkrahjes së procesit të dialogut dhe bashkpunimit mes komuniteteve në regjionin e Mitrovicës;
- Zhvillimit dhe përkrahjes së iniciativës lokale, OJQ-ve dhe institucioneve lokale;
- Zhvillimit dhe përkrahjes së procesit të demokratizimit mes lidhjeve ndërkombëtare të komunave;
- Përkrahja e edukimit mes lidhjeve ndërkombëtare të shkollave dhe shkollave verore;
- Financimit të infrastrukturës, ndriqimit rrugor, fushave të sportit, ngjyrosja e fasadave.

Realizimin e këtyre synimeve e arrijnë me aktivitetet vijuese:

Promovimit, organizimit dhe zhvillimit të kontakteve, dialogut dhe bashkpunimit mes komuniteteve në regjionin e Mitrovicës;

Zhvillimit të shoqërisë civile në Mitrovicë me përkrahje të aktiviteteve dhe trajnimeve së bashku me OJQ-të lokale, iniciativën qytetare dhe administratën lokale në fushat e mediave, minoriteteve, kulturës, femrave dhe të rinjve.

1. Zhvillimit të bashkpunimit ndërkombëtar të komunave nga regjioni i Mitrovicës, me krijimit të lidhjeve me komunat e Holandës;
2. Zhvillimin e bashkpunimit ndërkombëtar të shkollave të Mitrovicës me regjionin për rreth.

Objektivi dhe karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare

Identifikimi dhe objektiva e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare identifikohen qartë dhe dallohen nga informacionet tjera.

Emri i njësisë raportuese, njësia individuale që mbulohet, periudha e mbuluar, monedha raportuese dhe rrumbullakimi i shumave në euro, janë paraqit dukshëm dhe janë përsërit kur ishte e nevojshme për kuptimin e saktë të informacionit të paraqiturë.

Të gjitha zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë periudhës janë përfshir në fitim ose humbje.

Organizata nuk ka paraqit si zëra të jashtëzakonshëm as një zë të të ardhurave ose shpenzimeve, as në pasqyrën e të ardhurave as në shënimet shpjeguese.

Zërat materiale të të ardhurave dhe shpenzimeve janë paraqit ndaras për nga natyra dhe shuma.

Pasqyrat financiare paraqesin efektet financiare të transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera duke i grupuar ato në klasa të gjëra sipas karakteristikave të tyre ekonomike.

Objektiva e PF është plotësuar pasi që japin informacione të mjaftueshme lidhur me gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe ndryshimet e gjendjes financiare, janë të dobishme për përdoruesit në marrjen e vendimeve ekonomike, plotësojnë nevojat e shumicës së përdoruesve dhe pasqyrojnë kujdesin e treguar nga ana e drejtimit për burimet që i janë besuar.

Janë të kuptueshme nga përdoruesit me njohuri të arsyeshme për afarizmin, veprimtarin dhe kontabilitetin.

Informacionet krahasuese

Nuk ka pasur ndryshme në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, prandaj nuk ka pas nevojë për riklasifikim të shumave krahasuese dhe dhënie të informacioneve shpjeguese.

Mënyra e prezantimit dhe klasifikimit të artikujve në pasqyrat financiare është në përputhje, ajo është e njëjtë nga njëra periudhë në tjetrën dhe vazhdimisht është përdorur një politikë kontabël që zbatohet për çdo kategori/lloj.

Baza e përgatitjes së raporteve financiar

Raportet financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar si dhe me kërkesat e tjera për raportim të përcaktuara nga ligji.

Njohja-përfshirja në bilancin e gjendjes ose në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të një transaksioni është bërë kur ka qenë reale se çdo përfitim ekonomik në të ardhmen që lidhet me këtë transaksion do të rrjedhë tek ose nga subjekti dhe transaksioni ka pas kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri.

Matja është procesi i përcaktimit të shumave monetare me anë të të cilave do të njihen dhe barten në bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, element e pasqyrave financiare. Kjo përfshin zgjedhjen e një baze të veçantë të vlerësimit.

Pasuritë dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet raportohen ndaras.

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve

Aktivet dhe detyrimet janë paraqit sipas parimit afatshkurtër-afatgjatë;
Detyrimet e mbajtura për qëllime tregtimi janë klasifikuar si afatshkurtëra;

Detyrimi financiar që duhet të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve nga data e bilancit, për të cilin organizata nuk ka pas ndonjë të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyerjes së tij për të paktën dymbëdhjetë muaj nga data e bilancit, është klasifikuar si detyrim afatshkurtër.

Kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara

Organizata ka përgatitë pasqyrat financiare, duke përdorur kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Materialiteti dhe bashkimi

Mungesa ose deklarime të gabuara të zërave që janë materiale, (nëse në mënyrë individuale ose kolektive mund të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, vendime këto të marra në bazë të pasqyrave financiare), nuk ka patur.

Çdo klasë materiale e zërave të ngjashëm është paraqitur së bashkuar në pasqyrat financiare. Zërat që nuk janë të së njëjtës natyrë ose funksion janë paraqit ndaras me përjashtim të rastit nëse janë jo-materiale.

Zëri që nuk është individualisht material, është bashkuar me zëra të tjerë në pasqyrën përkatëse dhe është shqaruar në shënimet shpjeguese.

Kompensimi

Pasurit dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompensuar me përjashtim kur kjo ishte kërkesë ose lejohej nga një Standard ose një Interpretim.

Baza neto e raportimit

Fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup transaksionesh të ngjashme raportohen mbi bazën neto, fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit ose fitimet dhe humbjet nga instrumentat financiarë të mbajtur për tregtim.

Megjithatë fitime dhe humbje të tilla kur janë material raportohen ndaras.

Periudha raportuese, principi i krahasueshmërisë dhe kriteret e kontabilitetit

Periudha raportuese përfshin periudhën dymbëdhjetë mujore duke përfunduar më 31 Dhjetor të vitit.

Raporti i plotëson parimet e krahasueshmërisë (ka shifrat krahasuese), pasi që në vitin paraprak, ishte përpiluar sipas këtyre kërkesave dhe standardeve.

Parimi i vijimësisë së afarizmit

Raportet Financiare janë përgatiturë mbi supozimin se subjekti ka aftësi dhe qëllim që të vijojë dhe do të vazhdojë të funksionojë në një të ardhme të parashikueshme, se nuk ka synimin dhe as nuk ka nevojë të likuidojë ose të shkurtojë materialisht shkallën e operacioneve të veta.

Mundësia e vazhimit të aktivitetit të subjektit për dymbëdhjetë muajt e ardhshëm, bazuar në mjetet e disponueshme dhe planet nuk vihet në pyetje.

Principi akrual (i momentit të paraqitjes së transaksionit)

Raportet financiare janë të përgatitura sipas parimit akrual, kjo nënkupton që fondet janë njohur në momentin e pranimit, kurse shpenzimet janë njohur në momentin e ndodhjes, në shumicën e rasteve momenti i ndodhjes është identik me momentin e pagesës.

Parimi akrual bënë të mundshme që efektet e ndryshimeve, qoftë rritja apo zvogëlimi i pasurisë, të njihen që në momentin e shfaqjes së tyre, pavarësisht nga momenti hyrjes apo daljes së parasë.

Personeli

Personeli është me profesione të llojllojshme. Evidencat mbi personelin, si psh. kontratat e punësimit, CV-te dhe dokumentacioni tjetër personal, janë të arkivuara në regjistrator të veçantë në formë të rregullt.

Përgjegjësit, të drejtat dhe detyrat e personelit janë të definuara në përshkrimin e punës i bashkangjitur kontratave të punësimit.

Kontratat dhe evidencat e personelit janë të ndara nga evidencat tjera.

Pagat neto janë paguar me transfer bankar.

Auditimi, metodologjia, kriteret dhe objektivi

Metodologjia dhe teknikat e auditimit që kemi përdor janë në përputhshmëri me ato të parapara me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të mbështetura me testet substanciale siç janë: verifikimi i origjinalitetit të dokumentacionit mbështetës, verifikimi i ekzistencës fizike dhe çregjistrimit të pasurisë, verifikimi i saktësisë së perlloraritjeve dhe sipas nevojës hulumtimi i funksionimit të sistemit kompjuterik.

Kemi vlerësuar përshtatshmërinë e sistemit të evidencave për përgatitjen e raporteve financiare me qëllim të raportimit të dobësive eventuale të vërejtura në punën e zyrës ose në teren, vlerësimin e përshtatshëm të riskut, vizitën e vendeve të zhvillimit të projekteve apo njohja me materialin (raporte të shkruara, fotografi apo incizime, lista me nënshkrime etj.) nga momenti i zhvillimit për projektet e përfunduara si dhe saktësinë dhe plotësinë.

Gjate punës jemi udhëhequr nga kriteret e kredibilitetit, profesionalizmit, pavarësisë dhe shërbimit kualitativ.

Objektivi i auditimit është vlerësimi në thellësi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të vendosura nga drejtimi, me qëllim që të përcaktojë nëse ato po funksionojnë me kosto efektive për arritjen e objektivave dhe që janë në gjendje të identifikojnë mangësitë dhe të ndërmarrin veprime korigjuese. Ky auditim përfaqëson punën më efektive të Auditimit sepse, nëse kontrollet operojnë ashtu siç është parashikuar, atëherë Audituesi dhe drejtimi i organizatës mund të përfitojnë siguri nga kontrollet e vendosura.

Auditimi poashtu përfaqëson ekzaminimin e veprimtarive të subjektit, në procesin e realizimit të objektivave, në këndvështrimin e përputhjes së tyre me ligjet dhe rregullat. Auditimet e përputhshmërisë kanë për qëllim të testojnë nëse organizata vepron në përputhje me legjislacionin përkatës të fushës ku ajo zhvillon aktivitetet e veta.

Auditimi është procesi i vlerësimit të objektivave, programeve dhe shkallës së realizimit të tyre, në lidhje me kursimin, dobinë dhe përfitimet.

Auditimi kryhet për të vlerësuar saktësinë dhe plotësinë e regjistrimeve dhe gjendjeve të llogarive, duke përdor teste thelbësore, rishikime analitike dhe procedura të tjera vlerësimi të cilat mund të përfshijnë ose të mos përfshijnë testet funksionale apo rishikime të transaksioneve.

Auditimi përcakton nëse informacioni financiar, i dhënë nga subjekti, paraqet në mënyrë të besueshme pozitën financiare dhe rezultatet e operacioneve të audituara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Auditimi përqëndrohet vetëm në kontrollet e vendosura në organizatë. Ky lloj auditimi mund të përfshijë auditimin e të gjithë kontrolleve të sistemit të TI ose vetëm të një fushe, si për shembull, të fushës së llogarisë.

Përmbledhje e Politikave të Kontabilitetit

Deklarata të rëndësishme mbi politikat e kontabilitetit

Politikat kontabël janë parimet, bazat, marrëveshjet, rregullat dhe praktikat e veçanta që janë zbatuar në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.

Një ndryshim në vlerësimin kontabël është një rregullim i shumës së mbartur të një aktivi ose detytimi, ose shumës së konsumit periodik të një aktivi, që vjen nga vlerësimi i gjendjes aktuale të aktivitetit dhe detyrimit, si dhe përfitimeve të ardhshme të pritshme dhe detyrimeve të lidhura me aktivin dhe detyrimin.

Ndryshimet në vlerësimet kontabël vijnë nga informacioni i ri apo zhvillimet e reja dhe nuk janë korigjime të gabimeve.

Politikat e kontabilitetit të përshkruara nga subjekti janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

Në mungesë të një Standardi ose një Interpretimi që zbatohet veçanërisht për një transaksion, ngjarje apo kusht tjetër, drejtimi ka përdorë gjykimin e tij në zhvillimin dhe zbatimin e politikës kontabël që ka rezultuar në informacionin i cili është i besueshëm.

Për të përmbushur detyrimet e kërkuara nga Standardet e Kontabilitetit, "CBM", ka vlerësuar se nuk është e nevojshme që të shpalos informacionet për të gjitha kërkesat.

Organizata mund të jap informacione shtesë nëse përputhja me ndonjë kërkesë specifike të Standardeve të Kontabilitetit është e pamjaftueshme.

Organizata, në rast nevojë, jep informacione shpjeguese për natyrën dhe shumën e ndryshimit në vlerësimin kontabël që ka efekte në periudhën aktuale apo kur pritet të ketë efekt në periudhat e ardhshme, përveç rastit të dhënies së informacionit shpjegues të efektit për periudhat e ardhshme kur është i pazbatueshëm vlerësimi i këtij efekti.

Nuk ka pasur ndryshime në vlerësimet kontabël që përfaqëson një rregullim në lidhje me rritjen e një aktivi ose pasivi që paraqitet si rezultat i një informacioni të ri apo zhvillimeve të reja që nuk janë korigjime të gabimeve.

Pasuritë dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet janë raportuar ndaras.

Organizata ka procedurë të shkruara (manual) mbi politikat e kontabilitetit e cila përcakton principet e llogaridhënjes, dokumentimit dhe kontrolleve të brendshme.

Organizata udhëheq evidencat në aplikacionin e kontabilitetit (QuickBooks), me hyrje të dyfishtë nga i cili burojn informatat për përpilimin e raporteve financiare. Poashtu ka dy të punësuar me përgaditje adekuat në kontabilitet dhe financa.

Qasja në aplikacion është e kufizuar me nivele varësisht prej kompetencave. Korigjimet eventuale bëhen me kërkesa të veqanta që ruhen, por edhe aplikacioni e ruan historikun e ndryshimeve të bëra dhe personit që e ka kry atë veprimi.

Llogarit e arkëtushme dhe të pagueshme

LLA dhe LLP dhe detyrimet tjera të pagueshme paraqiten me vlerën e tyre reale.

Organizata në raportet e veta si llogari të arkëtushme-pasuri tjera ka raportuar pjesën e papaguar nga donatorët për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara dhe disa avanse të dhana të punësuarve.

Obligimet ndaj partnerëve për shpenzime akruale, paraqiten si detyrime-LLP.

Pasuritë

Pasuritë janë regjistruar në shumën e parasë ose ekuivalentet e saj të paguara ose në vlerën e drejtë të nevojshme për të blerë asetet e përmendura në kohën e blerjes.

Pasuria paraqitet me koston historike, vlerën e mbeturë nga viti paraprak, plus blerjet e vitit, minus zhvlerësimi i vitit si dhe zhvlerësimi i akumuluar.

Për të gjitha grupet, zhvlerësimi është përlogarit sipas metodës lineare në shkallë 20%.

Shpenzimet e zhvlerësimit janë të përfshira në shpenzime të përdorimit të fondeve të vitit.

Mjetet themelore në 2014, janë zhvlerësuar tërësisht edhe pse ende kanë vlerë përdorimi, për këtë arsye nuk kemi shuma të paraqitura në zërin e pasurisë për vitin raportues 2015 dhe 2016.

Për pasurinë e zhvlerësuar por me vlerë përdorimi udhëhiqet evidencë e veçantë dhe përcillet ekzistenca e tyre.

Rivlerësimi i pasurisë nuk është bërë, prandaj në raporte nuk ka reflektime nga rivalorizimi.

Prokurimi

Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve që kalojnë shumat e caktuara dhe janë domethënëse bëhen përmes njoftimeve të hapura, duke mbledhur së paku tri oferta dhe duke zgjedhur optimalen nga komisioni për hapjen e ofertave. Organizata ka procedurë të shkruara-MANUAL të prokurimit por mbështetet edhe në procedurat e imponuara nga donatorët. Në vitin 2016 është vepruar sipas kësaj praktike.

Kapitali

Organizata ka paraqit pasqyrën e ndryshimeve në kapital neto mes dy datave të bilancit që tregojnë rritjen ose pakësimin në aktivet neto të saj gjatë periudhës.

Madhësia e kapitalit dhe mënyra e drejtimit me kapitalin, janë faktorë të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë nga përdoruesit kur vlerësojnë nivelin e rrezikut të një subjekti dhe aftësinë e tij për të përballuar ngjarjet e pafavorshme e të papritura.

Informacioni lidhur me kapitalin ipet sepse është i dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme.

Kapitali i CBM është 29,337€ dhe përben 32% të pasurive gjithësejt.

Paraja

CBM ka llogari bankare bazë dhe llogari të projekteve në PCB.

Pagesat dhe inkasimet janë bërë nga këto llogari bankare.

Janë tre pjesëtarë të organizatës të autorizuar për llogarinë. Nënshkrimi paralel është i obligueshëm për realizimin e transaksioneve nga llogaria.

Bilanci përmblyllës i mjeteve në llogaritë bankare të PCB (fq.13/5 e raportit) janë konfirmuar nga pasqyra bankare dhe nga bankat.

Transaksionet në valutë të huajë, risku i valutës, rreziku i likuiditetit

Valutat e huaja janë këmbyer në Euro (€), duke përdorur kursin e këmbimit të asaj date, diferencat e këmbimit të valutave të huaja qofshin fitim apo humbje, janë paraqit në pasqyrën e të hyrave. Në fundë të periudhës, pozicionet monetare janë raportuar duke përdorur kursin e këmbimit të vlefshëm në ditën e fundit të këmbimit. Burimet e organizatës dhe raportet financiare të lëshuara nga or-

ganizata janë shprehurë në Euro.

Rreziku i valutës paraqet rrezikun që vlera e drejtë ose rrjedhjet e parasë së gatshme të ardhshme të një instrumenti financiar do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Çdo diferencë këmbimi që rrjedh nga njohja e një zëri monetar me një kurs të ndryshëm nga ai me të cilin është njohur fillimisht gjatë periudhës, ose është njohur në pasqyrat financiare të mëparshme, njihet në fitim ose humbje.

Raste të tilla nuk janë evidentuar.

Rreziku i Likuiditetit që një entitet do të ndeshë vështirësi në shlyerjen e obligimeve që kanë të bëjnë me detyrimet financiare të cilat vijnë për shkak të mundësisë (e cila shpesh mund të jetë e largët) që një entiteti mund t'i kërkohej të paguajë detyrimet e tij më herët sesa është pritur.

Niveli i likuiditetit është i kënaqshëm. Pasurit qarkulluese janë të mjaftueshme për mbulimin e detyrimeve afatshkurta.

Të ardhurat- donacionet

Gjatë vitit 2016, organizata ka njohur fondet nga të gjitha burimet, sipas llogarive bankare, e shpalosur në Shënime shpjeguese në Fq.10 Pika 1 dhe 2.

Të hyrat janë paraqitur në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në vlerë reale në datën e pranimit në bankë. Këto fonde kanë qenë në disponim për përdorim dhe janë 100% në para.

Burimet nuk janë njohur në tërësi gjatë këtijë viti, pasi që nuk janë shpenzuar, pra janë trajtuar si të hyra të shtyra që mbesin për tu shfrytëzuar për periudhën e ardhshme.

Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur në pasqyrën e shpenzimeve kur është krijuar ulje në përfitimet ekonomike që lidhet me ulje të një aktivi ose rritje të një detyrimi dhe kur ka pasur mundësi të matet me besueshmëri. Shpenzimet grupohen në pasqyrën e të ardhurave sipas funksionit (Shpenzimet programore) dhe sipas natyrës. Njohja e shpenzimeve ka ndodhur njëkohësisht me njohjen e një rritje në detyrimet ose me një ulje në aktivet.

Shpenzimet janë të mbështetura me dokumentacion original, siç janë fletëpranimit, faturat, kontratat, listpagesat dhe pasqyra bankare. Shpenzimet janë në nivelin e çmimeve të tregut.

Shpenzimet janë njohur në koston reale të tyre pra ato janë shprehur në shuma reale në momentin e ndodhjes apo pagesës.

E personelit

Kostoja e personelit u është paguar të punësuarve dhe të angazhuarve me kontrata shërbimi në përfundim të detyrave të parapara. Pagesat janë krye mes llogaris bankare me transfere, pasi që kanë nënshkruar fletëpunën dhe kanë paraqitur evidencat mbi kohën e angazhimit.

Kontributi pensional

Pensionet janë kalkuluar sipas ligjit të aplikueshëm mbi pensionet. 5% janë paguar nga i punësuarit dhe 5% nga organizata. Afatet e pagesave dhe raportimit janë respektuar.

Organizata nuk ka Fond pensional të vetin as mundësi të pagesave në formë të akcioneve, për të punësuarit, në këtë bazë nuk ka detyrime të identifikuara më 31.12.

Tatimi në paga

Tatimi në paga është mbajtur në burim dhe paguar në afatet e caktuara, sipas shkallëve mujore të pa-

rapara me ligj.

Shpenzimet programore

Kostoja e programeve është mbështetur me fatura të furnitorëve. Pagesa është e mbështetur me fatura dhe pasqyra bankare apo dokument të arkës për pagesat me të gatshme.

Programet e zhvilluara gjatë vitit janë të paraqitura në Fq.11/3,4 të Raportit dhe janë vazhdimësi e synimit ktyesote:zhvillimi dhe ndërtimi i mardhënjeve mes komuniteteve në regjionin e Mitrovicës.

Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative përfshijnë shpenzimet e punës së drejtimit në CBM, shërbimet ekzekutive, financat dhe administrata, ato të procesit të punës në zyre për realizimin e qëllimeve elementare të organizatës (vizitave studimore, trajnimeve, reprezentacionit, ndërtimin e institucioneve, karburanti, qirat, udhëtimeve, akomodimi dhe shpenzimeve të zyrës, materialit shpenzues, mirëmbajtjes së veturës, telefonit, internetit, auditimit të jashtëm, etj.)

Provizioni bankar është kalkuluar në bazë të pasqyrës bankare.

Për përdorimin e veturës dhe shpenzimet e derivateve, organizata aplikon libër për përcjelljen e kilometrazhës, prandaj është e mundur të bëhet ndarja mes udhëtimeve për nevoja private dhe nevoja të organizatës.

Shpenzimet e qirasë

Këto shpenzime përbajnë kompenzimin që është bërë në emër të qirasë për objektet ku është e vendosur selia e CBM dhe ku zhvillon aktivitetet dhe menaxhimin e projekteve në vendin e zhvillimit të projektit.

Tatimimet (mbajtja në burim)

Subjekti si organizat Jo-Qeveritare, jo fitimprurëse, e regjistruar sipas ligjit (NR.04/L-57) " Liria e bashkimit në organizatat jo-qeveritare" është subjekt i Tatimit në të ardhurat personale në Kosovë (Ligji 05/L-028). dhe Ligjit 03/L-084), Mbi pensionet në Kosovë të cilët i ka respektuar mes pagesës së tatimeve dhe kontributit në të ardhura personale për punëtorë.

CBM nuk është obligues i Tatimin në të ardhura e Korporatave sipas ligjit (L-05/L-029) "Tatimi në të ardhurat e korporatave" pasi që nuk ka realizuar të ardhura komerciale gjatë periudhës fiskale.

CBM ka respektuar dhe plotësuar obligimin nga Ligji Nr. 05/L-028 , mbi mbajtjen e 9% nga qiraja në momentin e pagesës së qiras dhe e ka transferuar atë shumë në llogarin e caktuar.

CBM është regjistruar si deklarues i TVSH. Deklarata e muajit 12/2016 tregon kreditim prej 29,441€, kurse realisht kjo shumë është kalkuluar si shpenzim i vitit 2016, por jo te projekti por te shpenzimet e CBM, kurse në rast rimbursimi trajtohet si e hyrë.

Ky kreditim nuk është paraqiturë si kërkesë-pasuri në Bilancin e gjendjes dhe nuk është trajtuar fare.

Palët e ndërlidhura

Si transaksion me palët e ndërlidhura, ku një palë ka mundësin e kontrollimit të palës tjetër ose ka ndikim të rëndësishëm në palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe biznesore për transfer të kërkesave dhe obligimeve (kredive, kontratave afariste me punëtorë dhe biznese të ndërlidhura me drejtorin ose me ndonjë pronësi të përbashkët), nuk janë identifikuar.

Huazimet

Huat njihen me vlerën e tyre nominale plus shpenzimet shoqëruese si tarifat, skontot e mundshme

dhe shpenzimet tjera lidhur me huan. Huat që janë të shprehura në monedha të ndryshme nga € regjistrohen me kursin historik dhe rivlerësohen me kursin e fundit të vitit-datën e raportimit. Diferencat e këmbimit pasqyrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve qoftë si përfitim apo humbje.

Kostot e huazimit njihen si shpenzim i periudhës në të cilën ajo është krijuar.

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë në shpenzimet financiare.

Huat e pagueshme janë detyrime financiare, të ndryshme nga të pagueshmet tregtare afatshkurtra me kushte normale (të zakonshme) të kredisë.

Organizata nuk ka pasur huazime gjatë vitit, si rezultat, nuk ka kosto të huamarrjes gjatë kësaj periudhe.

Provizionet dhe detyrimet e shtyra

Donacionet e pashfrytëzuara-të hyrat e shtyra nga viti 2015 (116,217€) në vitin 2016. u trajtuan si shtesë e të hyrave të vitit në fillim të vitit, kurse ato të fundit të vitit 2016. (44,860€) janë treguar si të hyra të shtyra në fund të vitit.

Krahasim me vitin 2015 tregon ulje për 71,357€.

Rezervat

Organizata nuk ka ndarë rezerva financiare gjatë kësaj periudhe.

Dividenta

Organizata si OJQ, humanitare, jofitimprurëse, nuk ka deklaruar shuma të dividendëve të njohurë si shpërndarje neto gjatë periudhës dhe vlerën përkatëse për aksion.

Zotimet

Nuk ka zotime që lidhen me shpenzimet kapitale, lisingun financiar ose operativ.

Pasurit dhe obligimet kontigjente

Nuk ka raste të evidentuar të gjykatës ose depozite lidhur me organizatën, drejtorët ose punëtorët e sajë që mund të rezultojë në detyrimet e ardhshme të organizatës.

Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së bilancit përfshijnë të gjitha ngjarjet deri në datën e autorizimit të pasqyrave financiare për publikim.

Nuk ka ngjarje me rëndësi që kanë ndikim të rëndësishëm në bilancin e gjendjes.

SHKURTESAT

CBM	Community Building Mitrovica
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PF	Pasqyra Financiare
EUR	Euro
PCB	ProCredit Bank
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
NF	Numri Fiskal
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ZQ	Zyra Qëndrore
QB	QuickBooks-Software
LIA	Llogarit e Arkëtrueshme
LIP	Llogarit e pagueshme